

# Drejtoria Arsmore e Filadelfias

**Klasa e Kopshtit, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for kindergartners (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

## **Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:**

- Flasin rreth personazheve dhe ti vendosin ato në një tregim, të cilën ata e kanë dëgjuar apo lexuar.
- Ritregojnë një pjesë sipas rendit të leximit apo dëgjimit.
- Përdorin figurat dhe fjalët për të kuptuar një tregim.
- Të lexojnë sëpaku 50 fjalë që përsëriten në shumë tregime si ran, with, us, the, etj.
- Të pikturojnë diçka dhe të shkruajnë shënime për pjesët e ndryshme të vizatimit.
- Të spellojnë saktë disa nga fjalët që ata ndeshin më shpesh në lexim apo në të folur si: are, with, play, you.
- Të kopjojnë fjalët e përditëshme që shikojnë në lagje apo pranë shtëpisë.
- Të shkruajnë fjali të shkurtëra dhe të bëjnë një listë të shkurtër të gjërave si :ushqime që ata pëlqejnë,emra të kafshve etj.



# Matematikë

## Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

- Të kuptojnë dhe përdorin fjalët si: over, under, above, below, next to dhe between
- Të krahasojnë numrat (më e madhe, më e vogël, më shumë se, më pakse)
- Të përdorin objekte ose pikturat për numrat 0-20
- Të lexojnë dhe shkruajnë numrat deri në 20
- Të përdorin objekte për të numëruar, renditur, dhe grupuar sipas madhësisë, ngjyrës ose kategorisë
- Të njohin dhe emërtojnë monedhat (pennies, nickels, dimes, quarters)
- Të ndajnë pjesë të barabarta midis dy njerëzve
- Të flasin rreth motit lidhur me temperaturën dhe stinët Të bëjnë matje duke përdorur objekte, si format e drurit (blocks), kapset e letrës (paperclip) ose pulla plastike (plastic chips)
- Të përdorin objekte dhe fotografi për të treguar rreth vetes tyre dhe ambjenti
- Të njohin figurat bazë si trekëndëshi, katrori, drejtëkëndëshi dhe rrethi
- Të numërojnë me zë nga 1-50

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:**

- Të përshkruajnë ndryshimet e motit sipas stinëve, si psh. moti i ngrrohtë në verë dhe i ftohtë në dimër
- Të përdorin shqisat (të parit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit, dhe të dëgjuarit) për të zbuluar rreth vetes dhe mjedisit rrotull tyre
- Të grupojnë dhe përshkruajnë objekte sipas përbërjes tyre (formës, përbërjes, madhësisë, peshës, ngjyrës, përmbajtjes dhe lëvizjes)
- Të zhvillojnë ndjenjën e respektit dhe kuptimit për jetën, si bimët dhe kafshët
- Të kryejnë kërkime shkencore duke punuar individualisht dhe në grup



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:**

- Spjegojnë si individët, familjet dhe grupet kanë ngjashmëri dhe dallime.
- Japin fakte rreth historisë Afrikanë-Amerikane.
- Kuptojnë që njerëzit dhe vendet ndryshojnë me kalimin e kohës.
- Kuptojnë dhe diskutojnë faktin, që të gjitha familjet kanë nevoja jetësore bazë.
- Përqëndrohen në zhvillimin e një qëndrimi pozitiv ndaj vetes, familjes dhe të tjerëve.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:**

- Të flasin rreth shëndetit personal dhe të praktikojnë zakone të mira për shëndetin. Të njohin ushqimet e shëndetshme dhe rëndësinë e vaktit të mëngjesit
- Të identifikojnë raste emergjente të zakonshme; djegjen, rrëzimet, dhe prerjet
- Të njohin aktivitete që nxisin një shëndet të mirë fizik
- Të njohin të mirat e bashkëpunimit dhe kooperimit.

# Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:**

## **Art**

- Përdorin materiale të ndryshme artistike për të skicuar, pikturuar dhe bërë skulpturë.
- Të gjejnë objektin qëndror në një punë artistike si një person, shtëpi ose lule.
- Të japin opinionin e tyre për një punë artistike.

## **Muzikë**

- Ecin, vrapojnë , hidhen, kërcëjnë dhe marshojnë me muzikë.
- Këndojnë ninulla dhe këngë popullore

# **Drejtoria Arsmore e Filadelfias**

**Klasa e Parë, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for 1st Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Ritregojnë një tregim sipas rendit të dëgjimit apo leximit, ku përfshihen shumë detaje të rëndësishme.
- Flasin dhe shkruajnë për ndodhitë në fillim, në mes dhe në fund të një tregimi, të cilin ata e kanë dëgjuar apo lexuar.
- Lexojnë më së paku 100 fjalë, të cilat janë më të përdorshme në shumë tregime si p.sh. read, girl, sure, etj.
- Të bëjnë parashikime, çfarë mund të ndodhë në tregimin pasardhës.
- Lexojnë me zë të lartë, në mënyrë të rrjedhëshme dhe ekspresion.
- Spellojë me korrektesë fjalët që janë më të përdorëshme.
- Shkruajnë fjali në mënyrë korrekte dhe përdorin saktë shënjat e pikësimit.





# Matematikë

## **Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Të dijnë të ndajnë në  $\frac{1}{2}$  dhe  $\frac{1}{4}$  e pjesëve.
- Krahasojnë numrat (më i madh, më i vogël, më shumë se, më pak se, i njejtë)
- Paraqesin të njejtin numër në mënyra të ndryshme si p.sh.  $8+2$ ,  $5+5$ , dhjetë.
- Të zgjidhin ushtrime me mbledhje dhe zbritje të numrave me një dhe dy shifra.
- Identifikojnë vlerat e monedhave metalike të ndryshme si (pennies, nickels, dimes, quarters)
- Masin gjatësinë e objekteve të ndryshme.
- Të njohin kohën në orët me shifra dhe ato tradicionale (me akrep) dhe të përcaktojnë sa kohë ka kaluar .
- Të mbledhin dhe rregjistrojnë të dhëna si p.sh. të motit.
- Të tregojnë që kuptojnë shembuj të modeleve duke thënë çfarë vjen më tej në numrat, format, ose objektet e përdorur.
- Përdorin shenjat  $+$ ,  $-$ , dhe  $=$  për të krijuar një pjesë tregimore me numra.
- Emërtojnë, vizatojnë, përshkruajnë format gjeometrike dy dimensionale si trekëndëshat, katrorët dhe drejtë-këndëshat.
- Nunërojnë me 2-sha, 5-she dhe 10-she.
- Të kuptojnë të dhjetat janë sa një të dhjetat e një numri dhe dhjetë dhjetëshe bëjnë njëqind.

# Shkencë

## **Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Të spjegojnë zbulimet e tyre duke shkruar dhe vizatuar rreth gjetjeve të tyre.
- Të grupojnë objektet e ndryshme sipas veçorive të tyre fizike: përbërja, përmasat, ngjyra etj.
- Përshkruajnë veçoritë sipas 3 gjëndjeve të materies: e ngurtë, e lëngët, e gaztë.
- Eksplorojnë ndryshimet e materies nga njëra formë në tjetrën, si duke vrojtuar një copë akulli, që kthehet nga forma e ngurtë në të lëngët.
- Vrojtojnë, përshkruajnë dhe rendisin materialet tokësore, duke u bazuar në cilësi të ndryshme.
- Përshkruajnë dhe krahasojnë disa karakteristika të bimëve dhe të kafshëve.
- Ndjekin investigime praktike për të zbuluar dhe kuptuar botën e tyre.
- Regjistrojnë vrojtimit në librin e shënimeve të shkencës.



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Spjegojnë si individët, familjet dhe grupet kanë ngjashmëri dhe dallime.
- Kuptojnë dhe diskutojnë faktet rreth historisë Afrikanë-Amerikane.
- Njohin dhe kuptojnë konceptin e ndryshimit në mjedis të ndryshme.
- Spjegojnë ditët e ndryshme të festave dhe ditëve të veçanta, që festohen në komunitetin e tyre apo të tjerëve.
- Aplikojnë konceptet bazë ekonomike në shtëpi, shkollë dhe komunitet.
- Të njohin se si përdoret teknologjia në shtëpi, shkollë dhe në komunitet.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Kuptojnë përbërësit e një karakteri të mirë:besueshmëria, ndershmëria, respekti, qytetaria.
- Kuptojnë ndryshimin midis ilaçeve mjekësore dhe jo mjekësore.
- Të dijnë çfarë të bëjnë për një prekje/kontakt të sigurtë dhe prekjet e rrezikëshme.
- Të bëjnë 30 minuta Edukim Fizik pa ndjerë lodhje të madhe.
- Të marrin pjesë ne lojra, ku përfshihen hedhjet dhe kapjet.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

### Art

- Përdorin material të ndryshme artistike për të skicuar, pikturuar dhe bërë skulpturë.
- Të gjejnë objektin qëndror në një punë artistike si një person, shtëpi ose lule.
- Të japin opinionin e tyre për një punë artistike.

### Muzikë

- Të luajnë ritme të thjeshta për të shoqëruar këngët, vargjet dhe poezitë.
- Këndojnë ninulla dhe këngë popullore.

# **Drejtoria Arsmore e Filadelfias**

**Klasa e Dytë, Udhëzues për Prindërit**  
*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*  
*Parent Study Guide for 2nd Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Përshkruajnë personazhet, evidentojnë ngjarjet kryesore, vendndodhjen ose problemet në një tregim ose tekst që ata kanë lexuar ose dëgjuar.
- Lexojnë në mënyrë të pavarur tregime të gjata dhe libra, ku përfshihen edhe ata me kapituj.
- Flasin rreth ideve kryesore në tregimet dhe librat që ata lexojnë.
- Bëjnë lidhje midis informacionit të ri të marrë nga një tregim apo libër dhe asaj që fëmija ka njohuri ndërkohë rreth një teme apo libri tjetër, filmi, ose programi televiziv.
- Shkruajnë rreth një teme specifike, si rreth një kafshe shtëpiake që i pëlqen më shumë, në një paragraf të plotë.
- Bëjnë përshkrime, raporte, letra dhe instruksione për mënyrën se si të bëjë diçka.



# Matematikë

## Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të

- Identifikojnë numrat e plotë dhe thyesat.
- Paraqesin të njëjtin numër me mënyra të ndryshme, p.sh.,  $18+12, 20+10, XXX$
- Njohin lidhjen midis mbledhjes dhe zbritjes së numrave.
- Mbledhin dhe zbresin numrat tek dhe dyshifrorë.
- Zgjidhin probleme me paratë duke përdorur dollarët dhe centët.
- Identifikojë kur duhen përdorur njësitë matëse inches, feet dhe yards.
- Të njohin kohën në orët me shifra dhe ato tradicionale (me akrep) dhe të përcaktojnë sa kohë ka kaluar .
- Bëjnë parashikime, mbledhin, ndajnë sipas llojeve, organizojnë, paraqesin dhe interpretojnë të dhënat në skica, grafikë dhe tabela.
- Njohin dhe shtrijnë përdorimin e modeleve me forma dhe numra.
- Zgjidhin fjali me numra dhe përcaktojnë pjesët që mungojnë.
- Përdorin shenjat +,-, dhe = për të krijuar një pjesë tregimore me numra.
- Emërtojnë, vizatojnë, përshkruajnë format gjeometrike dy dhe tre dimensionale si trekëndëshat, katrorët dhe drejtë-këndëshat.
- Spjegojnë me fjalët e tyre zgjidhjen e një problem matematik.
- Lidh mbledhjen e përsëritur.

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Përdorin instrumentet matëse, si vizorja për të mledhur informacion për objekte të ndryshme.
- Kuptojnë konceptin e ndryshimit të motit çdo ditë, por gjërat si temperature mesatare ose rreshjet ndjekin një mesatare mujore.
- Identifikojnë instrumentet e përdorur nga metereologët për vrojtimin e konditave atmosferike.
- Spjegojnë që ndryshimet në botën e gjallë çfaqen gjatë gjithë kohës dhe kanë ciklet tyre e jetësore ku përfshihet lindja, rritja, riprodhimi dhe vdekja eventuale.





# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Kuptojnë dhe shpjegojnë gjeografinë e komunitetit të tyre.
- Analizojnë si individët, familjet dhe grupet kanë ngjashmëri dhe dallime.
- Studjojnë në mënyrë investigative dhe paraqesin një ekspozë rreth historisë Afrikano-Amerikane.
- Tregojnë se kuptojnë si komunitetet ndryshojnë me kalimin e kohës.
- Diskutojnë vartësinë e njerëzve nga ambienti fizik dhe përdorin burimet natyrore për nevojat e tyre jetësore.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Kuptojnë ndjenjat dhe rrugët më të mira për ti shprehur ato.
- Identifikojnë ndihmuesit e komunitetit në lagje.
- Identifikojnë rrugët për shmangien e një konflikti.
- Marrin pjesë në aktivitete ku përfshihen kërcimet, kthimet, hedhjet, zvarritjet, uljet dhe ngritjet.
- Demonstrojnë zbatim të rregullave për sigurimin e jetës kur ecin, kapërcejnë rrugën dhe ngasin biçikletën.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

### Art

- Tregojnë kontroll dhe konfidencë në përdorimin e lapsave, bojrave dhe argjilës për të bërë art.
- Dijnë që artistët bëjnë lloje të ndryshme arti nga një shumëllojshmëri ideshë.
- Përcaktojnë forma të ndryshme të artit si portreti, peisazhi dhe skulptura.

### Muzikë

- Luajnë ritme të thjeshta për të shoqëruar këngë, vargje dhe poezi të ndryshme.
- Këndojnë dhe interpretojnë këngë për të mësuar karakteristika të tilla si i lartë/i butë, shpejt/ngadalë.

# Drejtoria Arsmore e Filadelfias

**Klasa e Tretë, Udhëzues për Prindërit**  
*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*  
*Parent Study Guide for 3rd Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së tretë duhet të jenë të aftë të:**

- Lexojnë një gamë të gjërë tregimesh, librash dhe artikuj revistash.
- Lexojnë pa zë shumicën e kohës dhe pastaj flasin rreth subjektit që kanë lexuar.
- Identifikojnë idenë kryesore dhe ngjarjet më të rëndësishme si edhe detajet në një tregim ose libër.
- Përdorin shumëllojshmëri mënyrash leximi, për të kuptuar atë që kanë lexuar.
- Shkruajnë tregime, vjersha dhe skeçe.
- Punojnë në projekte kërkimore dhe raporte për studime sociale dhe shkencë.



# Matematikë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së tretë duhet të jenë të aftë të:**

- Kuptojnë numrat e plotë dhe thyesat.
- Numërojnë renditin dhe grupojnë objektet.
- Vlerësojnë, përafrojnë, rrumbullakosin, ose përdorin numrat e saktë.
- Vlerësojnë, nxjerrin konkluzione dhe shpjegojnë një përgjigje.
- Përdorin një vizore/jard/metër për matje sipas standardeve amerikane dhe me sistemin metrik.
- Të njohin kohën në orët me shifra dhe ato tradicionale (me akrep) dhe të përcaktojnë sa kohë ka kaluar .
- Përdorin objekte për matjen e sipërfaqeve (sipërfaqja që mbulohet nga një objekt si p.sh “Sa katrorë futen në një kuti këpucësh?”) dhe perimetrin ( distanca për rreth, si p.sh., “Sa katrorë janë rreth një kuti këpucësh? ).
- Gjejnë dhe tregojnë të dhënat në grafikë të ndryshëm.
- Përcaktojnë rezultatin e mundshëm duke përdorur spinnerat dhe numrat e kubit.(probabiliteti).
- Përshkruajnë të dhënat duke përdorur fjalët si më e madhe, më e vogël, më shpesh, më rrallë.
- Identifikojnë dhe përdorin modele të ndryshme.
- Mbledhin, zbresin, shumëzojnë dhe pjestojnë duke përdorur numrat, objekte dhe nunër tregimesh.
- Njohin dhe krahasojnë forma gjeometrike dy (trekëndësha, katrorë, katërkëndësha) dhe tre dimensionale (kube, prizma, cilindra).
- Shpjegojnë me fjalët e tyre zgjidhjen e një problem matematikor.

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së tretë duhet të jenë të aftë të:**

- Zhvillojnë aftësitë që theksojnë 5 shqisat ndërsa bëjnë punë shkencore.
- Ndërtojnë një kuptim të koncepteve bazë në shkencën e tokës si p.sh., identifikimin e shtresave të tokës, karakteristikat e tyre dhe spjegojnë ciklin e shkëmbinjve.
- Njohin që zëri është një formë e energjisë dhe që ai fillon kur një objekt vibron. Zëri përhapet në gaz, lëng dhe trupa të ngurtë.
- Zhvillojnë një kuptim që pemët kanë struktura të ndryshme të cilat shërbejnë për funksione të ndryshme në rritje dhe mbijetesë dhe se si pjesët e ndryshme të botës së gjallë veprojnë sëbashku (si psh rrënjët, trugu dhe gjethet e pemës).
- Bëjnë eksperimente investiguese për zbulimin dhe kuptimin e botës së tyre.
- Rregjistrojnë të dhënat në fletoren e shënimeve të shkencës.



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së tretë duhet të jenë të aftë të:**

- Spjegojnë cilësitë e një qëndrimi të mirë qytetar, duke identifikuar njerëz në lagjen e tyre të cilët bëjnë dallim.
- Diskutojnë rolin e shumëanshëm që individët luajnë në familje, vendin e punës dhe komunitet.
- Shqyrtojnë se si individët mund të nxisin ndryshime në lagje dhe në komunitet.
- Diskutojnë rolin e heronjve realë apo imagjinarë në formësimin e kulturës të komuniteteve.
- Diskutojnë si problemet dhe konfliktet janë zgjidhur nga udhëheqësit dhe komunitetet.
- Studjojnë, investigojnë dhe paraqesin një ekspozë rreth historisë Afrikano-Amerikane.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së tretë duhet të jenë të aftë të:**

- Njohin rëndësinë e frutave, zrazavateve, kalçiumit dhe ujit.
- Njohin situatat e dëmshme dhe si të telefonojnë 9-1-1.
- Kuptojnë se si sjelljet për shëndet të mirë ndihmojnë për të shmangur sëmundjet.
- Kryejnë ushtrime të thjeshta fizike si uljengritje, rotullime të trupit etj.
- Bëjnë driblime me këmbë si në futboll dhe me dorë si në basketboll.
- Kuptojnë rregullat rreth ujit.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së tretë duhet të jenë të aftë të:**

### Art

- Tregojnë kontroll dhe konfidencë në përdorimin e lapsave, bojrave dhe argjilës për të bërë art.
- Dijnë që artistët bëjnë lloje të ndryshme arti nga një shumëllojshmëri ideshë.
- Përcaktojnë forma të ndryshme të artit si portreti, peisazhi dhe skulptura.

### Muzikë

- Këndojnë këngë të ndryshme që përfaqësojnë stile dhe kultura të ndryshme.
- Këndojnë dhe interpretojnë këngë duke përdorur tonacione të ndryshme si me zë të lartë/ulët/shpejt/ngadalë.
- Lexojnë dhe shkruajnë melodi të thjeshta.



# Drejtoria Arsmore e Filadelfias

**Iasa e Katërt, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for 4th Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së katërt duhet të jenë aftë të:**

- Lexojnë pa zë shumicën e kohës dhe pastaj flasin rreth subjektit që kanë lexuar.
- Lexojnë dhe kuptojnë të gjithë llojet e librave, përfshirë ato biografike, informacione shkencore, përralla popullore dhe poezi.
- Bëjnë lidhje midis tregimeve dhe teksteve që kanë lexuar.
- I referohen tregimeve apo teksteve për të mbështetur opinionet e tyre.
- Flasin dhe shkruajnë rreth personazheve, vendndodhjen, problemeve dhe zgjidhjeve pas leximit.
- Shkruajnë llojshmëri pjesësh, si tregime, vjersha, skeçe, raporte dhe instruksione rreth faktit si duhet bërë diçka.



# Matematikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së katërt duhet të jenë aftë të:**

- Mbledhin, zbresin, shumëzojnë dhe pjestojnë.
- Njohin lidhjen midis thyesave dhe numrave dhjetorë.
- Rendisin, mbledhin dhe zbresin thyesa dhe numra dhjetorë të thjeshtë.
- Identifikojnë thyesat e verteta (proper fractions) ( $2/8$ ) nga thyesat e paverteta (improper) ( $8/2$ ).
- Zgjidhin problemet duke përdorur relacionin midis pjesës ndaj të tërës (raporti dhe proporcioni).
- Përcaktojnë perimetrin (distanca rreth) dhe sipërfaqen (madhësia që mbulohet brenda) me njësi katrore.
- Përdorin kartmonedha dhe monedha metalike për blerje dhe dhënie kusuri.
- Diskutojnë dhe interpretojnë të dhënat (më e madhja, më e vogla, më shpesh dhe midis).
- Përdorin tabela dhe grafikë, vija diagramash për të treguar të dhënat.
- Parashikojnë dhe përcaktojnë të gjitha kombinacionet dhe rezultatet e mundëshme.
- Numërojnë me 10-she, 25-she, 50-she, 100-she, and 1000-she.
- Identifikojnë, krahasojnë dhe klasifikojnë format e ndryshme nisur nga këndi i tyre (kënd i ngushtë kur është më pak se  $90^\circ$ , i drejtë =  $90^\circ$  dhe i gjërë, më shumë se  $90^\circ$ ).
- Spjegojnë me fjalët e tyre zgjidhjen e një problemi matematikor.

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së katërt duhet të jenë aftë të:**

- Zhvillojnë aftësitë që theksojnë 5 shqisat ndërsa bëjnë punë shkencore.
- Bëjnë pyetje nisur nga vëzhgimet.
- Krahasojnë rezultatet nisur nga të dhënat e mbledhura.
- Krijojnë grafikë dhe diagram dhe bëjnë parashikime dhe konkluzione.
- Krijojnë kuptim mbi faktin se si valët, era, uji dhe akulli ndryshojnë vazhdimisht sipërfaqen e tokës.
- Kuptojnë konceptet bazë të magnetizmit dhe elektricitetit. Forcat tërheqëse dhe shtytëse magnetike dhe zvogëlimi i tyre me rritjen e distancës.
- Spjegojnë ciklin jetësor të bimëve dhe kafshëve të ndryshme.
- Bëjnë eksperimente investiguese për zbulimin.



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së katërt duhet të jenë aftë të:**

- Aplikojnë pesë temat e gjeografisë: vendndodhja, lëvizja, vendi, rajoni dhe ndërveprimi i Fladelfias me banorët e saj.
- Shqyrtojnë rëndësinë e qënies të grupeve etnike dhe rolin e shumëfishtë, që ato kanë luajtur në zhvillimin e Pensilvanisë.
- Përshkruajnë historinë e kolonizimit të Pensilvanisë.
- Kuptojnë institucionet shtetërore sociale, ekonomike dhe politike dhe si veprojnë ato në ndihmë të qytetarëve të Pensilvanisë.
- Studjojnë, investigojnë dhe paraqesin një ekspozë rreth historisë Afrikanë-Amerikane.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së katërt duhet të jenë aftë të:**

- Njohin faktin që me rritjen, trupi ndryshon.
- Identifikojnë organet kryesore dhe vendndodhjen e tyre.
- Njohin mjeshtëritë për zgjidhjen e konfliktit.
- Marrin pjesë në lojra me ekipe, ndjekin rregullat e lojës, lozin me kujdes dhe tregojnë shpirt sportisti.
- Krijojnë një rutinë me muzikën.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së katërt duhet të jenë aftë të:**

### Art

- Tregojnë konfidencë në shprehjen e ideve dhe eksperiences të tyre në skicime dhe pikturë.
- Përdorin fjalorin bazë të artit për të përshkruar një vepër arti.
- Njohin ndryshimet midis artit realist dhe atij abstrakt.
- Krijojnë një plan, para se të bëjnë një punë arti.

### Muzikë

- Këndojnë dhe luajnë këngë të ndryshme duke përdorur notat muzikore.
- Improvizojnë ose kompozojnë këngë të shkurtëra duke përdorur burime zanore të ndryshme si trupin, kordat vokale dhe zëra të instrumenteve.

# Drejtoria Arsmore e Filadelfias

**Iasa e Katërt, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for 5th Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së pestë duhet të jenë aftë të:**

- Vazhdojnë të pasurojnë fjalorin në lexim, shkrim dhe në të folur.
- Lexojnë për të marrë informacion të ri.
- Lexojnë për kënaqësi libra dhe revista të ndryshme.
- Kuptojnë një problem apo konflikt në libër dhe flasin apo shkruajnë për zgjidhjen e përshtatëshme.
- Bëjnë lidhje midis tregimeve dhe teksteve që kanë lexuar dhe botës rreth tyre.
- Tregojnë dhe/ose shkruajnë një përmbledhje e cila jep idenë kryesore të leximit të tyre dhe ngjarjet ose detajet më të rëndësishme.
- Plotësojnë një projekt kërkimi ku përfshihet një raport me shkrim.
- Shkruajnë tregime me disa paragrafë.
- Shkruajnë vjersha, skeçe dhe raporte.





# Matematikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së pestë duhet të jenë aftë të:**

- Llogarisin dhe gjejnë lidhjet duke përdorur numrat e plotë, thyesat dhe numrat dhjetorë.
- Lokalizojnë numrat pozitivë dhe negativë në një rradhë numrash (bashkësi).
- Spjegojnë çfarë kuptojnë me numrat primarë, faktorët, shumëfishat dhe ato të përbërë.
- Krahasojnë numrat (baraz me, më i madh se, dhe më i vogël se).
- Grumbullojnë, organizojnë, paraqesin dhe analizojnë të dhënat në rrugë të ndryshme.
- Gjejnë mesataren, të mesmen (numrin e mesit) mënyrën (më e shpeshta) dhe shkallën (diferenca midis më të madhes dhe më të voglës) e të dhënave.
- Parashikojnë ose përcaktojnë të gjitha kombinacionet dhe rezultatet e pritëshme si p.sh "Sa paisje mund të bëhen me 6 bluza dhe 8 panta-llona?
- Logaritin mundësinë që një ngjarje e thjeshtë të ndodhë.
- Përdorin metoda të ndryshme për zgjidhjen e madhësive të panjohura në ekuacione të thjeshtë algjebrikë me një të panjohur (zgjidhje për  $x$ ).
- Klasifikojë shumëkëndëshat sipas veçorive të tyre dhe këndeve si trekëndësha, rombe dhe paralelograme.
- Përcaktojnë dhe krahasojnë perimetrat (distance rreth) dhe sipërfaqet (sipërfaqja e brëndëshme) e formave të ndryshme.
- Kuptojnë veçoritë e një rrethi.
- Spjegojnë me fjalët e tyre zgjidhjen e një problemi matematikor.

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së pestë duhet të jenë aftë të:**

- Zhvillojnë aftësitë që theksojnë 5 shqisat ndërsa bëjnë punë shkencore.
- Përdorin njohuritë e mëparshme, kur bëjnë vrojtime.
- Bëjnë parashikime dhe hipoteza bazuar në vrojtimet.
- Projektojnë investigime me një kontroll dhe një ose dy variabla.
- Mbledhin, organizojnë dhe paraqesin të dhëna në mënyrë të pavarur.
- Ndërtojnë koncepte se si transformohet energjia diellore.
- Njohin që dielli është burimi kryesor i energjisë për njerëzit dhe ata e përdorin në mënyra të ndryshme.
- Projektojnë dhe zhvillojnë eksperimente me variabla. Nxënësit duhet të jenë në gjëndje të spjegojnë shkakun dhe pasojën.
- Studjojnë marrëdhëniet në një ekosistem që tregojnë marrëdhëniet e një organizmi me ambientin e tij.
- Bëjnë eksperimente investiguese për zbulimin dhe kuptimin e botës së tyre.
- Rregjistrojnë të dhënat në fletoren e shënimeve të shkencës.



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së pestë duhet të jenë aftë të:**

- Demonstrjnë kuptimin e rajoneve gjeografike të Shteteve të Bashkuara.
- Spjegojnë impaktin e eksplorimit dhe kolonizimit të Amerikës.
- Diskutojnë idetë, vlerat, besimet dhe vendimet që kontribuan në krijimin e qeverisë tonë.
- Analizojnë çështjet që çuan në Luftën Revolucionare dhe atë Civile.
- Spjegojnë reformat politike, ekonomike dhe sociale që formësuan Amerikën.
- Demonstrjnë kuptimin e Historisë Afrikano-Amerikane.
- Shqyrtojnë rolin e grupeve të ndryshme etnike në zhvillimin e Historisë të Shteteve të Bashkuara.

# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së pestë duhet të jenë aftë të:**

- Identifikojnë cilësitë e një marrëdhënie të shëndetëshme.
- Njohin përdorimin dhe abuzimin me ilaçet.
- Njohin huliganizmin (bullying) në të gjithë format e tij, përfshirë dhe atë me mjetet elektronike.
- Njohin qëllimin e kontrollit shëndetësor.
- Kuptojnë sulmin dhe mbrojtjen në situatë loje.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së pestë duhet të jenë aftë të:**

### Art

- Përdorin materilet artistike në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurtë.
- Pëshkruajnë subjektin, idenë ose simbolin në një punë arti duke përdorur fjalor artistik.
- Njohin punën e një historiani të artit.

### Muzikë

- Këndojnë dhe luajnë melodi me saktësi dhe shprehitë e duhura.
- Njohin dhe analizojnë muzikën nga perspektiva historike dhe kulturore.

# **Drejtoria Arsmore e Filadelfias**

**Klasa e Gjashtë, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for 6th Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së gjashtë duhet të jenë aftë të:**

- Spjegojnë disa prej strategjive që përdoren për kuptimin e pjesës së leximit përpara, gjatë dhe pas leximit, tilla si: Talk Across the Fingers, The 5 Ws, dhe TAG It a 3 (Strategji që përdoren në ndihmë të nxënësit për kuptimin, folur apo për të shkruar rreth një pjese leximi)
- Lexojnë dhe kuptojnë tekste të ndryshme përfshirë letërsinë historike, romanet, poezinë, përrallat, letërsinë epike, mitet, legjendat dhe dramat.
- Lexojnë dhe diskutojnë tekstet informative të tilla si: revistat, artikuj gazetash, tekste dhe studime shkencore dhe sociale.
- Përdorin mjeshtëri artistike për të planifikuar, skicuar, rishikuar dhe publikuar shkrimet për një qëllim të caktuar.
- Shkruajnë pjesë të ndryshme si tregime, drama, poezi dhe raporte.



# Matematikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së gjashtë duhet të jenë aftë të:**

- Zgjidhin problema duke aplikuar radhën e veprimeve dhe lidhjen e numrave me thyesat, numrat dhjetorë, numrat e plotë dhe përqindjet.
- Përdorin kalkulatorët për të eksploruar situatat me numrat e përbërë.
- Bëjnë, kontrollojnë dhe verifikojnë parashikimet dhe spjegojnë arsyet
- Konvertojnë njehsitë e zakonshme dhe metrike në të njesitë sistem matjeje si p.sh., inch në yard.
- Zgjidhin problemet ku përfshihet perimetri (distance rreth), sipërfaqja (sasia/masa që shtrihet brënda) dhe volumi (kapaciteti brënda në).
- Identifikojnë llojet e këndeve (i ngushtë=më i vogël se  $90^\circ$ , i drejtë= $90^\circ$  dhe i gjërë = më shumë se  $90^\circ$ ).
- Bëjnë grafikë të shkallëzuar.
- Përcaktojnë mënyrën më të mirë për paraqitjen dhe interpretimin e të dhënave në një seri.
- Përkrahajnë mesataren, të mesmen(numrin e mesit)mënyrën (më e shpeshta) dhe shkallën (diferenca midis më të madhes dhe më të voglës) e të dhënave
- Përcaktojnë shanset që një ngjarje e thjeshtë të mund të ndodhë, p.sh., "Cili është shansi që një monedhë që rrotullohet të bjerë në njëren anë tre here rradhazi?"
- Shikojnë një model dhe përcaktojnë çfarë do të vijë më mbrapa, p.sh., 7, 12, 17, 22, ..... (Rregulli është, shto pesë dhe numri tjetër është 27).
- Hartojnë dhe vendosin pikat në një plan koordinatash.
- Shpegojnë fjalorin e matematikës (linjat e simetrisë, mozaikë figurash, refleksionet, rrotullimet, transformimet, paralelin, perpendikularen, ngjashmërinë dhe përputhshmërinë) për figurat gjeometrike.
- Identifikojnë dhe masin pjesët e një rrethi (qendra, rezja, perimetri, këndet qendrore dhe diametric).

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së gjashtë duhet të jenë aftë të:**

- Bëjnë pyetje bazuar në vërtetimet.
- Bëjnë përgjithësime rreth rezultateve eksperimentale.
- Aplikojnë matematikën në kontekstin e shkencës.
- Ndërtojnë një kuptim të koncepteve të tokës nëpërmjet modeleve dhe hartave.
- Vërojnë efektin e ujit në formësimin e tokës.
- Interpretojnë teoritë shkencore për strukturën e universit.
- Përgjithësojnë historinë dhe të ardhmen e fluturimeve hapësirë të njerëzimit.
- Spjegojnë nevojën e zhvillimit të një qëndrimi për respektin dhe mirëkuptimin për jetën. Përshkruajnë ndryshimet në kushtet e ambientit, nga natyra apo nga veprimtaria njerëzore të cilat mund të ndikojnë në mbijetesën e organizmave të ndryshëm dhe të të gjithë botës së gjallë.
- Bëjnë eksperimente investiguese për zbulimin dhe kuptimin e botës së tyre.
- Rregjistrojnë të dhënat në fletoren e shënimeve të shkencës.





# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së gjashtë duhet të jenë aftë të:**

- Diskutojnë idetë dhe strategjitë e teksteve financiare si p.sh., menaxhimi i parave dhe i aplikojnë ato në situatat e përditshme.
- Përdorin pesë temat e gjeografisë: vendndodhjen, lëvizjen, vendin, rajonin, dhe ndërveprimin për t'ju përgjigjur pyetjeve gjeografike dhe analizën e koncepteve gjeografike.
- Identifikojnë modelet e rëndësishme në lëvizjen e njërëzve, të mirave materiale dhe ideve për gjatë kohës dhe vendit.
- Analizojnë ndërveprimin midis njërëzve dhe ambientit të tyre fizik.
- Diskutojnë se si toka, historia dhe kultura e Amerikës Latine ka influencuar zhvillimin e hemisferës perëndimore.
- Spjegojnë se si gjeografia e Amerikës së veriut ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe përhapjen e kulturës së Indianëve të Amerikës.
- Krahasojnë dhe nxjerrin dallimet midis sistemeve politike të Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara.
- Spjegojnë zhvillimin e komunitetit Kamboxhian në Filadelfia
- Diskutojnë rregullat që drejtojnë Sistemin e Drejtësisë për të miturit në Pensilvani.
- Paraqesin një kuptim të historisë Afrikano Amerikane.

# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së gjashtë duhet të jenë aftë të:**

- Kuptojnë ndikimin e medias në sjelljen e adoleshentëve.
- Demonstrojnë ndjeshmëri për personat e sëmurë
- Kuptojnë pse matura është sjellja më e sigurtë për adoleshentët.
- Njohin efektet e stresit në shëndet dhe sjellje.
- Zgjerojnë njohuritë në fushën e sportit.
- Projektojnë një plan personal për ruajtjen e shëndetit.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së gjashtë duhet të jenë aftë të:**

### Art

- Kuptojnë si të përdorin ngjyrën, vijën dhe format për krijimin e një pune arti.
- Përshkruajnë subjektin, simbolin ose idenë në një punë arti duke përdorur fjalor artistic.
- Shkruajnë një paragraf ku përshkruajnë mendimin e tyre për një punë artistike

### Muzikë

- Këndojnë dhe luajnë në dy dhe tre pjesë harmonike duke përdorur notat muzikore me saktësi dhe shprehjen e duhur.
- Njohin dhe demonstrojnë stile të ndryshme dhe zhanre të muzikës duke kënduar dhe luajtur instrumentet muzikore.

# **Drejtoria Arsmore e Filadelfias**

**Klasa e Shtatë, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for 7th Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së shtatë duhet të jenë aftë të:**

- Spjegojnë disa prej strategjive që përdoren për kuptimin e pjesës së leximit përpara, gjatë dhe pas leximit, tilla si: Talk Across the Fingers, The 5 Ws, and TAG It a 3 (Strategji që përdoren në ndihmë të nxënësit për kuptimin, folur apo për të shkruar rreth një pjese leximi)
- Lexojnë dhe kuptojnë tekste të ndryshme përfshirë letërsinë historike, romanet, poezinë, përrallat, letërsinë epike, mitet, legjendat dhe dramat
- Lexojnë dhe diskutojnë tekstet informative të tilla si: revistat, artikuj gazetash, tekste dhe studime shkencore dhe sociale.
- Përdorin mjeshtëri artistike për të planifikuar, skicuar, rishikuar dhe publikuar shkrimet për një qëllim të caktuar.
- Shkruajnë pjesë të ndryshme si tregime, drama, poezi dhe raporte.



# Matematikë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së shtatë duhet të jenë aftë të:**

- Identifikojnë dhe zgjidhin problema me numra të plotë, thyesa, numra dhjetorë, numrat pozitivë/negativë, përqindjet, eksponencialet, rrënjën e numrave, dhe simbole shkencore
- Zgjedhin dhe përdorin njesitë e duhura dhe masin gjatësinë, sipërfaqen dhe volumin e figurave gjeometrike
- Llogarisin distancën, raportin, kapacitetin, sipërfaqen, peshën, masën dhe këndet
- Gjejnë perimetrin (distanca përreth), perimetrin e rrethit dhe sipërfaqen (masa e pjesës së mbuluar) të trekëndëshave, katërkëndëshave, rrathëve dhe poligonëve të tjerë
- Kuptojnë se si shuma e dy këndeve është e barabartë me  $90^\circ$  ose  $180^\circ$
- Mbledhin, ndërtojnë, organizojnë, paraqesin dhe analizojnë të dhënat nga jeta e përditshme
- Bëjnë vrojtime dhe paraqesin rezultate grafike
- Kuptojnë përqindjen e shansit që një ngjarje të ndodhë
- Parashikojnë dhe përcaktojnë të gjitha kombinacionet dhe rezultatet e mundshme, p.sh., "Sa dopjo lugë akulloresh mund të bëhen me 40 lloje aromash të ndryshme akulloreje, pa u përsëritur dy herë e njëjta aromë në një kupë?"
- Eksplorojnë dhe paraqesin vazhdimësinë e modeleve
- Zgjidhin barazimet dhe mosbarazimet matematikore
- Krijojnë modele të objekteve tre-dimensionale duke përdorur pipëza dhe shkopinjë dhëmbësh
- Spjegojnë me fjalët e tyre zgjidhjen e një problemi matematikor

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor, nxënësit e klasës së shtatë duhet të jenë aftë të:**

- Shpjegojnë ngjashmëritë dhe diferencat që gjenden midis gjërave të gjalla dhe se si këto gjallesa janë organizuar
- Detajojnë rolin e qelizës si tulla bazë në ndërtesën e jetës
- Spjegojnë lidhjet mes tipareve gjenetike dhe trashëgimisë
- Përshkruajnë elementët bazë të meteorologjisë, duke përfshirë përbërjen e atmosferës së tokës
